



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEKANATI**

**RREGULLORE PËR PROCEDURËN E ZHVILLIMIT TË
PROVIMIT TË MBROJTJES SË GJUHËS SË HUAJ**

I. Hyrje

Provimi i mbrojtjes së gjuhës së huaj në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja është i ndërtuar sipas standardeve që parashikohen në Kuadrin e Përbashkët Evropian për Referencat e Gjuhëve (KPERGj), duke përfshirë testimin e katër kompetencave gjuhësore, sipas gjashtë niveleve të përcaktuara në këtë Kuadër.

Ky provim përpilohet, zhvillohet, korrigjohet dhe administrohet nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja.

Certifikata e mbrojtjes së njohjes së gjuhës shërben për të gjithë personat e interesuar që duan të dokumentojnë aftësitë në një gjuhë të huaj të caktuar sipas KPERGj.

II. Përshkrimi i provimit

Sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencës për Gjuhët (KPERGj) njohuritë në gjuhë ndahen në 3 nivele të mëdha të aftësisë së gjuhës: A, B dhe C - përkatësisht:

- **Përdoruesi bazë** ("*Përdoruesi themelor i gjuhës*", që kupton dhe përdor disa elementë të thjeshtë të gjuhës);
- **Përdorues i pavarur** ("*Përdorues i pavarur i gjuhës*", në këtë nivel mund të komunikojë "pa shumë fjalor", por mund të shprehë një mendim);
- **Përdorues i aftë** ("*Përdoruesi i aftë*", në këtë nivel përdoruesi i përafrohet nivelit të folësve vendas të gjuhës; jo vetëm që mund të flasim për çdo temë, por edhe me fjalorin dhe strukturat e duhura gramatikore).

Secili prej këtyre niveleve është i ndarë në dy të tjera, të cilat tregohen me shkronja - A1, A2, B1, B2, C1, C2 – në 6 nivele në total.

Nivelet e aftësive sipas KPERGj -së janë si më poshtë:

A – Niveli fillestar:

A1 - Niveli i kalimit (personi mund të kuptojë dhe përdorë shprehje të njohura, si dhe fjali të thjeshta, të cilat synojnë përmbushjen e nevojave konkrete. Mund të prezantojë veten dhe të tjerët dhe të pyesë të tjerët lidhur me informacionin bazë, p.sh. ku banojnë, a njohin persona të tjerë ose çfarë gjërash kanë, si dhe t'u përgjigjet edhe vetë pyetjeve të tilla).

A2 – Niveli bazë (personi mund të kuptojë fjali dhe shprehje të thjeshta, të cilat lidhen me tema me kuptim të drejtpërdrejtë (p.sh. informacione rreth personit dhe familjes, blerjeve, punës apo ambientit përreth). Mund të merret vesh në situata rutinë, ku bëhet fjalë për shkëmbimin e thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë të informacioneve lidhur me gjëra të njohura dhe të përditshme. Mund të përshkruajë me fjali të thjeshta prejardhjen dhe arsimin e vet, mjedisin rrethues dhe gjëra në lidhje të drejtpërdrejtë me nevoja të çastit.

B - Përdoruesi i pavarur:

B1 - Niveli i pragut (i ndërmjetëm) (personi mund të kuptojë idetë kryesore të një ligjërimi, nëse përdoret gjuha standarde dhe nëse bëhet fjalë për gjëra të njohura nga puna, shkolla, koha e lirë,

etj. Mund të përballojë shumicën e situatave gjuhësore me të cilat haset gjatë udhëtimeve në vendet ku flitet gjuha e mësuar. Mund të shprehet në mënyrë të thjeshtë dhe brenda kontekstit rreth temave të njohura dhe fushave personale të interesit).

B2 - Niveli i mesëm i lartë (personi mund të kuptojë përmbajtjen e teksteve komplekse lidhur me tema konkrete dhe abstrakte. Mund të merret vesh spontanisht dhe rrjedhshëm në një bisedë normale me vendas e cila zhvillohet mirë dhe pa ndonjë sforcim të madh mes palëve. Mund të shprehet lidhur me një spektër të gjerë temash në mënyrë të qartë dhe të detajuar, të mbajë një qëndrim për një çështje aktuale).

C - Përdorues i aftë:

C1 - Niveli i aftësisë profesionale (i avancuar), (personi mund të kuptojë një spektër të gjerë tekstesh të sofistikuar e të gjata dhe të përcjellë domethënie të nënkuptuara. Mund të shprehet në mënyrë spontane dhe të rrjedhshme, shpeshherë pa pasur nevojën për të kërkuar gjatë fjalët e duhura. Mund të përdorë në mënyrë të efektshme dhe elokumente gjuhën në jetën shoqërore dhe atë profesionale, apo në shkollë ose universitet. Mund të shprehet qartë, në mënyrë të strukturuar dhe të rrjedhshme lidhur me çështje të ndërlikuara dhe të vërë në përdorim në mënyrë të përshatshme mjete të shumëllojshme gjuhësore për ligjërime të ndryshme).

C2 - Niveli i aftësisë (zotërim i gjuhës), (personi mund kuptojë praktikisht pa asnjë vështirësi çdo gjë që lexon apo dëgjon. Mund të përmbledhë informacione nga burime të ndryshme me shkrim apo me gojë dhe të riprodhojë prej tyre arsyetime dhe sqarime në mënyrë koherente. Mund të shprehet spontanisht, rrjedhshëm dhe qartë dhe të shfaqë qartazi në çështje të ndërlikuara nuanca të imta kuptimore).

II.1 Komponentët e provimit të mbrojtjes së gjuhës së huaj sipas niveleve të KPERGj-së:

II.1.1. Komponentët e provimit të mbrojtjes së gjuhës së huaj NIVELI A1 janë:

Provimi A1 teston të katër aftësitë: të dëgjuarit, të lexuarit, të shkruarit dhe të folurit.

Pjesët janë si më poshtë:

Pjesa e parë (30 minuta) - Testimi i kuptimit të leximit, me 20 pyetje gjithsej.

Vendosen pesë tekste të shkurtra që janë fjali të thjeshta nga përditshmëria, si psh. lajmërimi me 3 – 4 fjali të shkurtra dhe të thjeshta. Pyetjet ndërtohen për aspektin kuptimor dhe gramatikor. Pyetjen ndërtohen me alternativa.

Pjesa e dytë (30 minuta) – Testimi i aftësisë së të shkruarit

Ndryshe nga nivelet e tjera, në këtë rast kandidatit i kërkohet që të plotësojë një formular (psh. emri, numri, adresa).

Pjesa e tretë (15 minuta) - Testimi i aftësisë së të dëgjuarit.

Kandidatit i lexohen disa lajmërimë të shkurtra dhe më pas pyetjet për informacion shumë specifik, si një orar i caktuar, çmim bilete, etj. Tekstet janë me gjuhë të thjeshtë dhe nga situata të përditshmërisë.

Pjesa e katërt (10 minuta) – Testimi i aftësisë së të folurit

Kandidati pyetet për informacion shumë të thjeshtë dhe bazik, si psh. emri, adresa, numri, komunikim me fraza dhe fjali të shkurtra në lidhje me shkëmbim informacioni nga përditshmëria.

Kandidatët duhet të tregojnë se arrijnë të prodhojnë informacion bazik për veten dhe po ashtu arrijnë ta kuptojnë kur kërkohet një informacion i tillë.

Shënim:

Secila pjesë ka 25 pikë dhe kandidati duhet të mbledhë të paktën 45 pikë që të arrijë të kalojë nivelin.

Komponentët	Pikët
Të lexuarit	xx/25
Të shkruarit	xx/25
Të dëgjuarit	xx/25
Të folurit	xx/25
	TOTALI 100

II.1.2. Komponentët e provimit të mbrojtjes së gjuhës së huaj NIVELI A2 janë:

Provimi A2 teston të katër aftësitë: të dëgjuarit, të lexuarit, të shkruarit dhe të folurit.

Pjesët janë si më poshtë:

Pjesa e parë (30 minuta) - Testimi i kuptimit të leximit, me 20 pyetje gjithsej.

Tekstet përbëhen nga fjali të shkurtra dhe të thjeshta, me tematikë nga jeta e përditshme. Pyetjet janë me alternativa, për aspekte kuptimore dhe gramatikore.

Pjesa e dytë (30 minuta) - Testimi i të shkruarit

Kandidati duhet të shkrujë një letër ose email të thjeshtë, ku kërkohet informacion bazik dhe mund të shkruajë informacion bazik për veten.

Pjesa e tretë (15 minuta) - Testimi i të dëgjuarit

Kandidatit i lexohen 2 tekste, i pari një lajmërim i thjeshtë dhe pyetjet kanë lidhje me informacione shumë specifike, si psh. orare, çmime, emra, etj.

Teksti i dytë ka fjalor më të ndërlikuar dhe përsëri pyetjet kanë lidhje me informacion specifik brenda tekstit.

Pjesa e katërt (10 minuta) - Testimi i të folurit

Kandidatit i bëhen pyetje duke filluar me informacion bazik, si gërmëzim emri, numër dhe duke vazhduar me pyetje për informacion më të detajuar, si veprimtari të kohës së lirë, apo atë që pëlqen ose jo kandidati.

Kandidatët duhet të tregojnë se arrijnë të prodhojnë informacion bazik për veten dhe po ashtu arrijnë ta kuptojnë kur kërkohet një informacion i tillë, si dhe arrin të krijojë komunikim me bashkëfolësin.

Shënim:

Secila pjesë ka 25 pikë dhe kandidati duhet të mbledhë të paktën 45 pikë që të arrijë të kalojë nivelin.

Komponentët	Pikët
Të lexuarit	xx/25
Të shkruarit	xx/25
Të dëgjuarit	xx/25
Të folurit	xx/25
	TOTALI 100

II.2 Komponentët e provimit të mbrojtjes së gjuhës së huaj NIVELI B1 janë:

Provimi B1 teston të katër aftësitë: të dëgjuarit, të lexuarit, të shkruarit dhe të folurit.

Pjesët përbërës janë si më poshtë:

Pjesa 1 (45 minuta) – Testimi i kuptimit të leximit, me gjithsej 30 pyetje.

Përfshihen:

- pesë njoftime të botës reale, mesazhe dhe tekste të tjera të shkurtra, përshkrime të ndryshme në tekste të shkurtra për një temë të caktuar.
- një tekst më të gjatë për të kuptuar në mënyrë më të detajuar, thelbin, përfundimin dhe kuptimin e përgjithshëm, si dhe qëndrimin dhe opinionin e shkrimtarit.
- një tekst më të shkurtër për të plotësuar boshllëqet me fjalët e dhëna.

Pjesa 2 (45 minuta) – Testimi i aftësisë së të shkruarit. Kjo pjesë përbëhet nga dy kërkesa për shkrim: një e-mail si dhe ose një artikull ose një histori. Çdo pjesë shkrimi duhet të jetë rreth 100 fjalë.

Pjesa 3 (20 minuta) – Testimi aftësisë së të dëgjuarit

Testi përbëhet nga 2 (dy tekste) që lexohen nga një folës i përparuar i gjuhës së huaj dhe përbëhet nga 10 pyetje. Teksti i parë është nga një situatë e përditshme dhe kandidati i bëhen 5 pyetje në lidhje me informacionin në tekst. Teksti i dytë ka natyrë akademike dhe përbëhet nga 3 pyetje argumentuese që bazohen në fakte dhe argumente brenda në tekst. Kandidatët lejohet të mbajnë shënime.

Llojet e pyetjeve janë me zgjedhje të shumëfishta dhe plotësuese.

Pjesa 4 (10 deri në 12 minuta) – Testimi aftësisë së të folurit. Testi i të folurit përbëhet nga katër pjesë të shkurta, dy të parat kandidati flet vetë mbi dy pyetje që drejtohen dhe dy të dytat behet bashkebisedim me testuesin.

Përfshihen përgjigje pyetjesh, përshkrime, diskutime mbi interesat, referencat, përvojat, opinionet, zakonet etj.

Kandidatët duhet të tregojnë se sa mirë mund të prodhojnë një gjuhë të folur spontane.

Shënim:

Secila pjesë ka 25 pikë dhe kandidati duhet të mbledhë të paktën 45 pikë që të arrijë të kalojë nivelin.

Komponentët	Pikët
Të lexuarit	xx/25
Të shkruarit	xx/25
Të dëgjuarit	xx/25
Të folurit	xx/25
	TOTALI 100

II.2.1 Komponentët e provimit të mbrojtjes së gjuhës së huaj NIVELI B2 janë:

Provimi B2 teston të katër aftësitë: të dëgjuarit, të lexuarit, të shkruarit dhe të folurit. Pjesët përbërëse janë si më poshtë:

Pjesa 1 (60 minuta) – Testimi i kuptimit të leximit, gramatikës dhe fjalorit. Kjo pjesë ka gjithsej 30 pyetje me zgjedhje të shumëfishta, pyetje me plotësim dhe pyetje me kombinim ose shoqërim.

Tekset në testin mund të jenë artikuj në gazeta dhe revista, raporte, letërsi artistike, reklama, letra, mesazhe, materiale informative (p.sh. broshura, udhëzues, manuale, etj.).

Përfshihen:

-një tekst me disa pyetje me zgjedhje të shumëfishta. Çdo pyetje ka katër alternativa (A, B, C ose D), dhe kandidatët duhet të vendosin se cila është përgjigja e saktë;

-një tekst me disa fjalë që mungojnë (boshllëqe). Kandidatët duhet të mendojnë për fjalën e duhur për çdo boshllëk;

-një tekst në të cilin mungojnë disa fjalë . Pas tekstit ka katër përgjigje të mundshme për çdo boshllëk dhe kandidatët duhet të zgjedhin përgjigjen e saktë (A, B, C ose D);

Pjesa 2 (60 minuta) – Testimi për aftësinë e të shkruarit. Do të shkruhen dy tekste, secili nga 140 deri në 190 fjalë. Kërkesa e parë është një ese. Për kërkesën e dytë, jepet një zgjedhje midis formateve të ndryshme të tekstit: artikull, letër, rishikim, etj.

Pjesa 3 (25 minuta) – Testimi i aftësisë së të dëgjuarit.

Testohet aftësia për të ndjekur dhe kuptuar një sërë materialesh të njohura të folura, të tilla si programe lajmesh, njoftime publike dhe burime të tjera, por që synojnë interesat e përgjithshme dhe praktike të kandidatëve.

Tekstet lexohen nga një folës i përparuar i gjuhës së huaj dhe përbëhet nga 10 pyetje. Teksti i parë është nga një situatë e përditshme dhe kandidatit i bëhen 5 pyetje në lidhje me informacionin në tekst.

Testi i të dëgjuarit përcakton aftësinë e kandidatit për të kuptuar gjuhën e huaj të folur, vlerëson aftësinë në kuptimi i ideve kryesore dhe informacionin e saktë faktik, identifikimin e tonit dhe emocionit, opinionit, pikëpamjes dhe qëllimit të folësit.

Pjesa 4 (10 deri në 12 minuta) – Testimi i aftësisë së të folurit.

Testi i të folurit përbëhet nga katër pjesë të shkurta. Në dy të parat kandidati flet vetë mbi dy pyetje që i drejtohen dhe në dy të dytat bëhet bashkëbisedim me testuesin.

Përfshihen përgjigje pyetjesh, përshkrime, diskutime mbi interesat, preferencat, përvojat, opinionet, zakonet etj.

Kandidatët duhet të tregojnë se sa mirë mund të prodhojnë një tekst të gjuhës të folur spontane.

Shënim:

Secila pjesë ka 25 pikë dhe kandidati duhet të mbledhë të paktën 45 pikë që të arrijë të kalojë nivelin.

Komponentët	Pikët
Të lexuarit	xx/25
Të shkruarit	xx/25
Të dëgjuarit	xx/25
Të folurit	xx/25
	TOTALI 100

II.3 Komponentët e provimit të mbrojtjes së gjuhës së huaj NIVELI C1 janë:

Provimi C1 teston të katër aftësitë: të dëgjuarit, të lexuarit, të shkruarit dhe të folurit.

Përshkrimi i Nivelit gjuhësor C1

Niveli C1 quhet nivel i pavarur. Ky nivel karakterizohet nga përdorimi i një game të gjerë ligjërimesh që favorizojnë një komunikim të lirshëm dhe spontan :

Kandidati mund të shprehet lirshëm dhe spontanisht pothuaj pa sforcim. Zotëron mirë një repertor të gjerë leksikor, boshllëqet e të cilit mbushen me anë të perifrazimeve. Kërkon rrallëherë shprehjet në mënyrë jo shumë të dukshme dhe përdor rallë strategjitë e evitimit të

tyre. Vetëm një temë konceptualisht e vështirë mund të pengojë që biseda të zhvillohet në mënyrë të natyrshme.

Pjesët përbërëse janë si më poshtë:

Pjesët përbërës janë si më poshtë:

Pjesa e parë (60 minuta) - Testimi i të lexuarit

Testi përbëhet nga 2 tekste dhe 40 pyetje gjithsej. Teksti i parë mund të jetë një artikull me informacion të përgjithshëm të përditshmërisë, ndërsa teksti i dytë duhet të jetë akademik, nga një fushë e caktuar. Pyetjet duhet të jenë me alternativa dhe përgjigje të shkurtra, si për aspekte gramatikore (psh. cilën fjalë zëvendëson X përemër) ashtu edhe për aspekte gjuhësore e kuptimore (psh. sinonime, antonime, perifrazime, kuptim apo fjali përmbledhëse të tekstit).

Pjesa e dytë (60 minuta) – Testimi i të shkruarit

Kandidati duhet të shkruajë një ese me 250-300 fjalë.

Tema e esesë do të jetë e përcaktuar paraprakisht dhe kandidati do të vlerësohet nëse ka përmbushur të gjithë elementët e një eseje, që nga struktura e deri te gabimet drejtshkrimore, duke arritur të shkruajë një tekst koherent dhe me natyrë akademike.

Pjesa e tretë (40 minuta) – Testimi i të dëgjuarit

Tekstet lexohen nga një folës i përparuar i gjuhës së huaj dhe përbëhet nga 10 pyetje. Teksti i parë është nga një situatë e përditshme dhe kandidati i bëhen 5 pyetje në lidhje me informacionin në tekst. Ndërsa teksti i dytë është i natyrës akademike dhe përsëri bëhen 5 pyetje në lidhje me tekstin. Ndërkohë kandidati mund të mbajë shënime.

Ai/ajo testohen për aftësinë për të kuptuar tekste të natyrave të ndryshme, arrin të kuptojë edhe informacion që është i nënkuptuar, duke identifikuar gjithashtu tonin, intonacionin dhe pikëpamjen e folësit.

Pjesa e katërt (15 -17 minuta) – Testimi i të folurit

Testi përbëhet nga 4-5 pyetje. 2 pyetjet e para janë të një natyre të përgjithshme dhe përskruese. Ndërsa pyetjet e tjera kërkojnë argumentim për çështje të caktuara, ku kërkohet që kandidati të mbajë një qëndrim dhe të arsyetojë për vendimin e tij/saj, duke përdorur fraza sinonimike apo perifrazime. Fjalitë duhet të jenë të strukturuar mirë, me fjali të përbëra, me shqiptimin e duhur dhe fjalorin e pasur dhe specifik për temën.

Shënim:

Secila pjesë ka 25 pikë dhe kandidati duhet të mbledhë të paktën 45 pikë që të arrijë të kalojë nivelin.

Komponentët	Pikët
Të lexuarit	xx/25
Të shkruarit	xx/25
Të dëgjuarit	xx/25
Të folurit	xx/25
	TOTALI 100

II.3.1 Komponentët e provimit të mbrojtjes së gjuhës së huaj NIVELI C2 janë:

Provimi C2 teston të katër aftësitë: të dëgjuarit, të lexuarit, të shkruarit dhe të folurit.

Përshkrim i nivelit C2

Niveli C2 është quajtur Zotërim i plotë i gjuhës,

Qëllimi është të karakterizohet shkalla e saktësisë, përshtatjes dhe lirshmërisë së gjuhës në ligjërimin e atyre që kanë qënë nxënës të nivelit të lartë. Përshkruesit e listuar në këtë nivel përfshijnë:

Kandidatët transmetojnë nuancat kuptimore me saktësi duke përdorur saktësisht një gamë të gjerë formash të veçanta;

kanë një zotërim të mirë të shprehjeve idiomatike dhe familjare të shoqëruara me konotacionet përkatëse që mund të shprehin; rimarrin dhe riformulojnë një vështirësi pa u vënë re nga bashkëfolësi.

Pjesët përbërëse janë si më poshtë:

Pjesa 1 (60 minuta) – Testimi i kuptimit të leximit gramatikën dhe fjalorin.

Kjo pjesë ka gjithsej 30 pyetje me zgjedhje të shumëfishta, plotësuese dhe që përputhen.

Tekset e përzgjedhura për testin mund të jenë të larmishme dhe që mbulojnë fusha të ndryshme të jetës së përditshme dhe profesionale si artikuj në gazeta dhe revista, raporte, letërsi artistike, reklama, letra, mesazhe, materiale informative (p.sh. broshura, udhëzues, manuale, etj.):

Përfshihen:

-një tekst me disa pyetje me zgjedhje të shumëfishta. Çdo pyetje ka katër opsione (A, B, C ose D), dhe kandidatët duhet të vendosin se cila është përgjigjja e saktë;

-një tekst me disa fjalë që mungojnë (boshllëqe). Kandidatët duhet të vendosin fjalën e duhur për çdo boshllëk në mënyrë që teksti të marrë kuptim;

-një tekst në të cilin mungojnë disa fjalë . Pas tekstit ka katër përgjigje të mundshme për çdo boshllëk dhe nxënësit duhet të zgjedhin përgjigjen e saktë (A, B, C ose D).

Pjesa 2 (60 minuta) – Testimi për aftësinë e të shkruarit. Do të shkruani dy tekste, secili nga 200 deri në 250 fjalë. Kërkesa e parë është një ese.

Për kërkesën e dytë, ju jepet një zgjedhje midis formateve të ndryshme të tekstit: artikull, reflektim, rishikim, etj.

Pjesa 3 (15-17 minuta) – Testimi aftësisë së të dëgjuarit.

Testohet aftësia për të ndjekur kuptuar një sërë materialesh të njohura të folura, të tilla si raporte, prezantimprojektesh profesionale, programe lajmesh, njoftime publike dhe burime të tjera, por që synojnë interesat e përgjithshme dhe profesionale të kandidatëve.

Tekstet lexohen nga një folës i përparuar i gjuhës së huaj dhe përbëhet nga 15 pyetje.

Teksti i parë është nga një situatë e përditshme dhe kandidatit i bëhen 5 pyetje në lidhje me informacionin në tekst.

Testi i të dëgjuarit përcakton aftësinë e kandidatit tuaj për të kuptuar gjuhën e huaj të folur, vlerëson aftësinë në kuptimin i ideve kryesore dhe informacionin e nënkuptuar, identifikimin e tonit dhe emocionit, opinionit, pikëpamjes dhe qëllimit të folësit.

Pjesa 4 (15 deri në 17 minuta) – Testimi i aftësisë së të folurit.

Testi i të folurit përbëhet nga katër pjesë të shkurta, dy të parat kandidati flet vetë mbi dy pyetje që drejtohen dhe dy të dytat bëhet bashkëbisedim me testuesin.

Përfshihen përgjigje pyetjesh, përshkrime, diskutime mbi interesat, preferencat, përvojat profesionale, raportime, argumentime, opinionet, zakonet etj.

Kandidatët duhet të tregojnë cilësi sa më të mirë të ligjërit si në saktësinë gramatikore ashtu edhe në ngjyrimin emocional dhe finesat e gjuhës së folur spontane.

Shënim:

Secila pjesë ka 25 pikë dhe kandidati duhet të mbledhë të paktën 45 pikë që të arrijë të kalojë nivelin.

Komponentët	Pikët
Të lexuarit	xx/25
Të shkruarit	xx/25
Të dëgjuarit	xx/25
Të folurit	xx/25
	TOTALI 100

Shënim:

Teza e provimit hartohet çdo muaj nga komisionet përkatëse të ngritura në nivel njësie bazë sipas niveleve të kërkuara nga kandidatët në momentin e regjistrimit.

III. Rregullorja për regjistrimin në provim

Provimi i gjuhës zhvillohet sipas kalendarit të publikuar në faqen web të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja. Provimi fillon në orën 09.00.

- Çdo person mund të regjistrohet për të kryer provimin e mbrojtjes me dokumentat përkatëse në dy mënyra, duke u paraqitur në zyrën përkatëse në mjediset e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja ose nëpërmjet adresës elektronike: mbrojtje_gjuhe.fgjh@unitir.edu.al
- Dokumentet e nevojshme për t'u regjistruar për provimin e mbrojtjes së gjuhës janë:
 - a) Dokument identifikimi (Kartë identiteti ose pasaportë, asnjë mjet tjetër nuk vlen për regjistrim);
 - b) Mandati i pagesës së tarifës së provimit.

Shënim: Në rast ndryshimi në mjetin e identifikimit, kandidati paraqitet paraprakisht me mjetin e ri të identifikimit dhe certifikatë familjare (në rast ndryshimi të mbiemrit) ose vërtetim të institucionit përkatës (në rast dëmtimi të mjetit identifikues).

- Kandidati i cili nuk mund të jetë i pranishëm ditën e provimit, megjithëse e ka bërë regjistrimin dhe pagesën, mund të kërkojë shtyrjen e provimit për muajin pasardhës të paktën 5 (pesë) ditë para provimit. Nuk parashikohet rimbursimi i pagesës.
- Regjistrimi duhet të kryhet deri në 10 (dhjetë) ditë para zhvillimit të provimit.
- Tarifa për provimin është 6.000 mijë lekë.

IV. Vlerësimi i provimit të gjuhës së huaj

Provimi do vlerësohet me pikë dhe më nivelet gjuhësore sipas KPERGj-së, elementë të cilët do të pasqyrohen në certifikatën e provimit të mbrojtjes së gjuhës.

Komponentët gjuhësorë do vlerësohen në këtë mënyrë:

1.Të lexuarit	25 pikë
2.Të shkruarit	25 pikë
3.Të dëgjuarit	25 pikë
4.Të folurit	25 pikë

V. Certifikata e mbrojtjes së gjuhës së huaj:

- Kandidati mund të tërheqë vërtetimin e provimit të gjuhës 20 ditë pas ditës së provimit.
- Është pa afat;
- Lëshohet në gjuhën përkatëse të provimit;
- Lëshohet vetëm njëherë;
- Njihet nga institucionet shqiptare;
- Mund të tërhiqet në çdo moment vërtetim i rezultatit, nëse kërkohet një i tillë.

VI. Administrimi i provimit

- Kandidatët paraqiten 30 minuta para zhvillimit të testit.
- Kontrollohen mjetet e identifikimit të kandidatëve.
- Kandidatët shoqërohen deri në sallë dhe ulen në vendet e caktuara nga administruesit.
- Lexohen udhëzimet në shqip për qëndrimin gjatë zhvillimit të testit.
- Në orën e caktuar të shpërndahen fletët e provimit për pjesën e të lexuarit. Asnjë kandidat nuk duhet të kthejë fletët pa u shpërndarë të gjitha fletët/libërthat.
- Mblidhen fletët e seksionit të të lexuarit.
- Shpërndahen fletët e seksionit të të shkruarit.
- Lexohen sqarimet përkatëse.
- Nuk lejohet të dalë asnjë kandidat pa u mbledhur të gjitha fletët.
- Afishohen listat me emrat e kandidatëve për secilën sallë për të kryer testin e të dëgjuarit dhe të folurit.
- Rezultatet e provimit shpallen 5 ditë pas kryerjes së provimit.